

VENDIM

Nr.547, datë 13.5.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË VLERAVE TË QIRASË PËR SIPËRFAQET UJORE, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AKUAKULTURËS INTENSIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 27 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, dhe të nenit 801 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet ujore u jepen me qira personave, juridikë e fizikë, vendas apo të huaj, për ushtrimin e veprimtarive të akuakulturës intensive, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.
2. Sipërfaqet ujore, që jepen me qira, janë në zonat detare, në ujërat e brendshme (pa përfshirë ujëmbledhësit e bujqësisë, që shërbejnë për ujitje) dhe në liqenet natyrore.
3. Njoftimi për botim për dhënien me qira të zonës shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për sipërfaqen, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin, që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.
4. Dokumentacioni, që duhet të paraqesin pjesëmarrësit në konkurrim, është:
 - Kërkesa për marrjen me qira të sipërfaqes ujore;
 - Regjistrimi në QKR;
 - Projekti teknik;
 - Planbiznesi i hollësishëm për zhvillimin e veprimtarisë;
 - Autodeklarimi se projekti përputhet me kërkesat mjedisore të zonës në fjalë;
 - Oferta për tarifën vjetore të detyrimit.
5. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:
 - Garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
 - Prania e specialistit të fushës, nëpërmjet CV-së profesionale, ku të tregohet përvoja në fushën e peshkimit dhe të akuakulturës;
 - Autodeklarimi se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, nuk ka detyrime tatimore ose detyrime të tjera.
6. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të sipërfaqeve ujore janë:
 - Niveli i investimit dhe i projektit;
 - Niveli i punësimit;
 - Tarifa e qirasë vjetore.
7. Me urdhër të ministrit ngrihet dhe vepron komisioni i vlerësimit të kërkesave të paraqitura. Urdhri i ministrit përmban:
 - a) Të dhënat e zonës: emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, çmimi dysHEME, afati;
 - b) Veprimtarinë, që mund të ushtrohet në zonë;
 - c) Pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, të përcaktuara sipas pikës 6 të këtij vendimi;
 - ç) Vendin, datën dhe orën, ku paraqiten dokumentet;
 - d) Përbërjen e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, i cili, në çdo rast,

përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë, specialistë të ministrisë;

dh) Dokumentacionin, që duhet të paraqesin konkurrentët.

8. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra:

a) Hap, në prani të konkurrentëve, dokumentacionin e paraqitur prej tyre, duke bërë të njohur të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti skualifikohet në prani të tij;

b) Harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruhen pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkaku, konkurrentët e kualifikuar dhe lista e dokumenteve të paraqitura prej tyre;

c) Bën shqyrtimin brenda 10 ditëve të ofertave të paraqitura dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi, sipas përcaktimit në urdhrin e ministrit. Subjektit, që paraqet vlerën më të lartë të propozuar, i jepen pikët maksimale për çdo element konkurrimi, ndërsa subjekteve të tjera pikët u llogariten në përpjesëtim të drejtë me vlerën më të lartë, të propozuar;

ç) Rendit, pas përfundimit të konkursit, konkurruesit, në bazë të pikëve të fituara;

d) Paraqet, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c” të kësaj pike, te ministri një informacion për zhvillimin e konkursit, së bashku me procesverbalin dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara.

9. Komisioni shpall subjektin fitues. Njoftimi për shpalljen fitues vendoset në këndin e njoftimeve të ministrisë.

10. Subjektet konkurruese, brenda 5 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te ministri, i cili, brenda 10 ditëve, i përgjigjet ankuesit me shkrim.

11. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme dhe pajisjes me leje mjedisore, ministria ose përfaqësuesi i pronës shtetërore lidh kontratën e qirasë dhe miraton kohëzgjatjen e projektit, i cili nuk mund të jetë më shumë se për 10 vjet.

12. Afati i kontratës për dhënien me qira të sipërfaqes ujore është i njëjtë me kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.

13. Për kategoritë ujore të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, çmimi i qirasë vjetore është 1 (një) euro për ha. Ky çmim do të zbatohet dhe për kontratat ekzistuese të qirasë, për periudhën që ka mbetur deri në mbarim të kontratës.

14. Pagesa e qirasë është vjetore dhe llogaritet nga data e lidhjes së kontratës. Ajo shlyhet në çastin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë, në vitet pasardhëse.

15. Të ardhurat e siguruara nga dhënia me qira e sipërfaqeve ujore administrohen, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të vendimit nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

16. Vendimi nr.135, datë 8.3.2006 i Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet.

17. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha